

# Kronikë nga mbledhja e 57-ë e KRD-ës

**SHKUP, 03.12.2012-** Në mbledhjen e sotshme, Këshilli i Radiodifuzionit (KRD) i miratoi Propozimudhëzimet e mëposhtme:

-Propozimudhëzim për shqiptimin dhe zbatimin e masave të cilat Këshilli i Radiodifuzionit i RM-ës ju shqipton radiodifuzerëve dhe operatorëve të rrjeteve të komunikimit publik;

-Propozimdoracak për vlerësimin e pluralizmit mediatik (Pluralizëm të brendshëm)

-Propozimudhëzim për krijimin e kushteve të tregut për rritje të qëndrueshme ekonomike të industrisë së medias dhe konkurrencë të ndershme.

Këshilli i Radiodifuzionit e miratoi versionin të punës së Strategjisë për zhvillimin e veprimtarisë radiodifuzive për periudhën 2013-2017 bashkë me Planin e Veprimit.

KRD vendosi që të japë dy vërtetime për paketa të regjistruara programore:

-Vërtetim për regjistrimin e paketës programore digjitale nr. 31 të Shoqatës për inxhiniering telekomunikimi, softuer, tregti dhe shërbime “БЛИЗУ МЕДИА ЕНД БРОУДБЕНД” – SHKUP, me

çka paketa e regjistruar programore si tërësi plotësohet me serviset e më poshtme programore: Koprenikus, KCN Music, Svet Plus, TVSH dhe Telesport.

-Vërtetim për regjistrimin e paketës programore nr. 8 për ritransmetim nëpërmjet rrjetit të komunikimit publik të Shoqatës për shërbime telekomunikimi DIGI PLUS MULTIMEDIA – Shkup për servisin programor televiziv RTV 21.

Këshilli vendosi ta urdhërojë rrjetin e komunikimit publik GLOBAL NET – Krushevë ta ndërpresë emetimin e serviseve programore televizive: Sport Klub, Sport Klub +, Fishing and Hunting , Golf Klub, Ultra dhe Cinemania, për shkak të ndërprerjeve për ritransmetimin e tyre me çka do të ve në dieni firmat S.C IKO Balkan S.R.L nga Bukureshti dhe IKOMEDIA- Beograd, si bartës të të drejtave për serviset e përmendura programore dhe urdhër për çkyçjen e serviseve programore televizive BOM (Best of Masedonia) dhe (K-15 Music), përshkak mosplotësimit të kushteve ligjore për regjistrimin e tyre në paketën programore.

KRD e miratoi Analizën e Strukturës së punësuarve në veprimtarinë radiodifuzive në bazë të përkatësisë etnike.

Duke marrë parasysh se SHTR GAUDEMUS RADIO KLASIK FM, Martin-Shkup ka bërë ndërryshimin e strukturës pronësore duke harmonizuar punën e vet komform nenit 11, dhe nenin 18 të ligjit për veprimtari radiodifuzive, Këshilli i Radiodifuzionit vendosi të ndërpres procedurën e nisur për marjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë radiodifuzive.

Për shkak se në Ditarin e TV Kanal 5 më datë 16 nëntor 2012

dhe në Ditarin e TV Sitel më datë 17 nëntor 2012 janë publikuar ndryshime dhe plotësime, respektivisht përgjigjes së Shoqatës për drejtim kolektiv të të drejtave të prodhuesve të Fenogramëve dhe artistëve të interpretuesve muzikor – MMI e plotësuar me koment, Këshilli vendosi që TV Kanal 5 dhe TV Sitel tua bëj të ditur se publikimi i përgjigjës respektivisht korrigjimi në këtë mënyrë është në kundërshtim me nenin 154 paragrafi 1 dhe nenit 3 të Ligji për veprimtari radiodifuzive.

Këshilli i Radiodifuzionit e miratoi Propozim mendimin për Informacionin dhe Plan veprimin për parandalimin dhe menaxhim të aktiviteteve dhe përmbajtjeve jolegale përmes informacionit dhe teknologjive informatike-telekomunikative dhe për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga të njëjtat në periudhën 2012 – 2014.